Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria-Vlada-Government*

# RREGULLORE Nr. 13/2012 PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM TË NËPUNËSVE CIVILË[1]

# REGULATION No. 13/2012 FOR EARLY RETIREMENT OF CIVIL SERVANTS[2]

# UREDBE Br. 13/2012 O PREVREMENOG PENSIONISANJA CIVILNIH SLUŽBENIKA[3]

[1] Rregullore nr. 13/2012 për pensionimin e parakohshëm është miratuar në mbledhjen e 79 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër nr.07/79 me datë 20.06.2012

[2] The Regulation no. 13/2012 for early retirement of civil servants was approved on 79 meeting of the government of the Republic of Kosovo with the deccission no.07/79, date 20.06.2012.

[3] Uredbe br. 13/2012 o prevremenog pensionisanja civilnih službenika osvojen je na 79sednice Vlade Republike Kosova, odluku br. 07/79, od 20.06.2012.

## QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVË

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 92 paragrafit 3, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 72 / 25.06.2010, Prishtinë) si dhe nenit 19.6 (6.2) të Rregullores nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.15/ 12.09.2011, Prishtinë),

Nxjerr:

## RREGULLOREN Nr. 13/2012 PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM TË NËPUNËSVE CIVILË

### Neni 1
### Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për pensionimin e parakohshëm të nëpunësve civilë, në institucionet e Republikës së Kosovës.

## THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Pursuant to article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, article 92, paragraph 3, of the Law no. 03/L-149 on the Civil Service of the Republic of Kosovo (Official Gazette of the Republic of Kosovo / no.72 / 25.06.2010, Prishtina) as well as Article 19.6 (6.2) of Regulation no. 09/2011 on the Work of the Government of Kosovo (Official Gazette of the Republic of Kosovo / no.15 / 12.09.2011, Prishtina),

Hereby issues:

## REGULATION No. 13/2012 FOR EARLY RETIREMENT OF CIVIL SERVANTS

### Article 1
### Purpose

This Regulation shall determine the rules and procedures for early retirement of civil servants in institutions of the Republic of Kosovo.

## VLADA REPUBLIKE KOSOVA

Shodno člana 93 (4) Ustava Republike Kosova, člana 92 stav 3, Zakona br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova (Službeni Glasnik Republike Kosova br. 72 / 25.06.2010, Priština) i člana 19.6 (6.2) Uredbe br. 09/2011 Rada Vlade Republike Kosova (Službeni Glasnik Republike Kosova br. 15 / 12.09.2011, Priština),

Donosi:

## UREDBE Br. 13/2012 O PREVREMENOG PENSIONISANJA CIVILNIH SLUŽBENIKA

### Član 1
### Svrha

Ova Uredbe odredjuje pravila i procedure o prevremenog penzijonisanja civilnih službenika, u institucijama Republike Kosova.

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Delokrug** |
| Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, me rastin e pensionimit të parakohshëm të nëpunësve civilë. | Provisions of this Regulation shall apply to all institutions of the Republic of Kosovo, in case of early retirement of civil servants. | Odredbe ove Uredbe sprovede se u svakoj instituciji Republike Kosova, prilikom prevremenog penzijonisanja civilnih službenika. |
| **Neni 3**<br>**Rastet për pensionim të parakohshem** | **Article 3**<br>**Cases for early retirement** | **Član 3**<br>**Slučaji za prevremeno penzionisanje** |
| 1. Nëpunësit civilë, nën kushtet e parapara me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe të kësaj Rregulloreje, mund të kërkojnë pensionimin e parakohshëm jo më shumë se dy (2) vjet para afatit të përcaktuar për pensionimin e tyre. | 1. Civil servants, under the terms of provisions of the Law no. 03/L-149 on Civil Service (hereinafter: the Law) and this Regulation, can apply for early retirement not earlier than two (2) years before the time of their retirement. | 1. Civilni službenici, pod predvidjenih uslova sa odredbama Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu (u daljem tekstu: Zakona) i ove Uredbe, možemo zahtevati prevremenu penziju ne više od dve (2)godine prije odredjenog roka za njihovo konačno penzijonisanje. |
| 2. Institucionet të cilat kanë në marrëdhënie pune nëpunës civilë, nën kushtet e parapara me dispozitat e Ligjit dhe të kësaj Rregulloreje, mund të pensionojnë nëpunësit civilë jo më shumë se dy (2) vjet para datës së pensionimit të tyre. | 2. Institutions, having employed civil servants, under the terms foreseen with the provisions of the Law and this Regulation, can retire civil servants not earlier than two (2) years before their retirement date. | 2. Institucije koji imaju na radnom odnosu civilne službenike,pod predvidjenim uslovima sa odredbama Zakona ove Uredbe, mogu da penzionišu civilne službenike ne više od dve (2) godine prije datuma njihovog penzijonisanja. |

| Neni 4<br>Procedura për pensionim të parakohshëm me kërkesë të nëpunësit civil | Article 4<br>Procedure for early retirement at request of civil servant | Član 4<br>Procedura prevremenog penzijonisanja putem zahteva civilnog službenika |
|---|---|---|
| 1. Nëpunësi civil, që plotëson kushtet e parapara në paragrafin 1, neni 3 të kësaj Rregulloreje, duhet të plotësojë Formularin nr. 1 (në tekstin e mëtejmë kërkesën) për pensionim të parakohshëm, që është i bashkëngjitur kësaj Rregulloreje. | 1. Civil servant who meets the conditions set forth under paragraph 1, article 3 of this Regulation shall fill in the form for early retirement, given in Annex 1 of this Regulation. | 1. Civilni službenik, koji popunio predvidjene uslove prema stavom 1, člana 3 ove Uredbe, treba popuniti formular o prevremenom penzijonisanju, koja je prestavljena u Aneksu 1 ove Uredbe. |
| 2. Kërkesa, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i dërgohet njësisë së personelit të institucionit përkatës, e cila do të verifikojë nëse plotësohen kushtet e parapara me paragrafin 1, neni 3 të kësaj Rregulloreje. | 2. According to paragraph 1 of this article, the form shall be sent to the personnel unit of relevant institution, which shall verify if the conditions foreseen under paragraph 1, article 3 of this Regulation are met. | 2. Formular, prema stava 1 istoga člana, dostavlja se jedinici personela dotične institucije,koja je dužna da proveri da li su popunjene predvidjene uslove stavom 1, član 3 ove Uredbe. |
| 3. Njësia e personelit ia dërgon kërkesën udhëheqësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil, për të dhënë pëlqimin. | 3. Personnel unit shall send the form to the immediate supervisor of civil servant who applies for early retirement for consent. | 3. Jedinica Personela dostavlja formular, koga treba da se odobrava, kod direktnog rukovodioca civilnog službenika, koji zahteva prevremeno penzijonisanje. |
| 4. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë shqyrton kërkesën, duke marrë parasysh: | 4. The immediate supervisor reviews the request/form by considering: | 4. direktni rukovodioc razmatra zahtev/formular, imajući u obzir: |
| 4.1. rëndësinë e punës që kryhet nga nëpunësi civil në kuadër të njësisë organizative; | 4.1. the importance of the work performed by the civil servant within the organizational unit; | 4.1. Važnost rada obavlja civilni službenika u okviru organizacione jedinice; |

| | | |
|---|---|---|
| 4.2. dallimin ndërmjet kostos së pagës dhe kompensimet e nëpunësit civil që pensionohet dhe pagës së nëpunësit civil që e zëvendëson atë; | 4.2. difference between the salary cost and compensation of retiring civil servant and the salary of civil servant who replaces him/her; | 4.2. razlika izmedju kostoa plate i nadoknade civilnog službenika koji se penzioniše i plate civilnog službenika koja zameni nju; |
| 4.3. planifikimin e personelit në njësinë organizative; | 4.3. planning of the personnel in organizational unit; | 4.3. planiranje personela u organizacijonu jedinicu; |
| 4.5. mundësinë e zëvendësimit adekuat dhe/apo mundësinë e kryerjes së detyrave të tij nga radhët e nëpunësve të tjerë civilë. | 4.5. the possibility of adequate replacement and/or the possibility of performing his/her tasks by other civil servants. | 4.5. mogučnosti adekuatnog zamenjivanja/ili mogučnostima za obavljanja njihovih zadataka u redovima ostalih civilnih službenika. |
| 5. Pas shqyrtimit të kërkesës, sipas paragrafit 4 të këtij neni, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, që kërkon pensionim të parakohshëm, jep mendimin e tij në afat prej 15 ditëve të punës, i cili i dërgohet njësisë së personelit. | 5. After reviewing the request/form, under paragraph 4 of this article, the immediate supervisor of civil servant who applies for early retirement, gives his/her opinion within 15 working days and sends it to the personnel unit. | 5. Nakon razmatranja zahteva/formularu, prema stava 4 istoga člana, direktni nadzornik civilnog službenika, koji zahteva prevremeno penzijonisanje, daje njegovo mišljenje u roku od 15 radnih dana, koji se dostavlja jedinici personela. |
| 6. Pas marrjes së mendimit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, njësia e personelit kompleton lëndën e nëpunësit civil, që kërkon pensionim të parakohshëm, dhe e dërgon te udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit. | 6. After receiving the opinion of the immediate supervisor, the personnel unit completes the case of civil servant applying for early retirement, and sends it to the highest administrative manager of the institution. | 6. Nakon dobivanja mišljenja direktni nadzornik, Jedinica personela kompletira predmet civilnom službeniku, koji zahteva prevremeno penzionisanje, i dostavlja višem upravnom rukovodiocu iste institucije. |
| 7. Udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit shqyrton kërkesën dhe merr | 7. The highest administrative manager of the institution reviews the request/form and | 7. Viši upravni rukovodioc iste institucije razmatra zahtev/formular i donese odluku |

| | | |
|---|---|---|
| vendim në pajtim me Ligjin dhe me këtë Rregullore. | takes decision in compliance with the Law and this Regulation. | shodno Zakona i ove Uredbe. |
| **Neni 5**<br>**Përmbajtja e vendimit për pensionim të parakohshëm** | **Article 5**<br>**Content of decision for early retirement** | **Član 5**<br>**Sadržaj odluke za prevremeno penzijonisanja** |
| 1. Vendimi për aprovimin e kërkesës për pensionim të parakohëshëm të nëpunësit civil, përveç të tjerave, duhet të përmbajë: | 1. The decision for approval of request for early retirement of civil servant, amongst others, should contain: | 1. Odluka za usvajanje zahteva o prevremenog penzijonisanje civilnog službenika, osim ostalih, treba da sadrži: |
| 1.1. datën e pensionimit të parakohshëm të nëpunësit civil; | 1.1. the date of early retirement of civil servant; | 1.1. datum prevremenog penzionisanja civilnog službenika; |
| 1.2. pagesën për pensionim të parakohshëm; | 1.2. payment for early retirement and all other rights; | 1.2. plaćenjne za prevremeno penzijonisanje i svaka druga prava; |
| 1.3. obligimet e nëpunësit civil ndaj institucionit sipas dispozitave ligjore në fuqi. | 1.3. obligations of civil servant towards the institution, according to legal provisions in force. | 1.3. obaveze civilnog službenika prema instituciji prema zakonskih odredbi koja su na snazi. |
| 2. Udhëheqësi me i lartë administrativ nxjerr vendim në rastet e mosaprovimi të kërkesës. | 2. If the request is not approved, a decision shall be issued by the immediate supevisor. | 2. Viši upravni rukovodioc donese rešenje u slučaju ako se ne usvaja zahtev. |
| 3. Njësia e personelit do ta informojë nëpunësin civil për vendimin e marrë nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, në afat prej 3 ditëve të punës. | 3. The personnel unit shall inform the civil servant on the decision taken by the highest administrative manager of the institution within three (3) working days. | 3. Jedinica personela treba da informiše civilnog službenika o donetom rešenju od strane višeg upravnog rukovodioca institucije, u roku od 3 radnih dana. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Kundër vendimit të udhëheqësit më të lartë administrativ, nëpunësi civil ka të drejtë ankese, në institucionin përkatës, në pajtim me Ligjin dhe me aktet përkatëse nënligjore. | 4. The civil servant has the right to appeal to the relevant institution, against the decision of the highest administrative manager, in compliance with the law and relevant bylaws. | 4. Protiv odluke višeg upravnog rukovodioca institucije civilni službenik ima pravo prigovora, u dotičnoj instituciji, shodno Zakona i dotičnih podzakonskih akata. |
| **Neni 6**<br>**Pensionimi i parakohshëm me iniciativë të institucionit** | **Article 6**<br>**Early retirement on the initiative of the institution** | **Član 6**<br>**Prevremeno Pensionisanje sa iniciativom institucije** |
| 1. Pensionimi i parakohshëm me iniciativë të institucionit mund të bëhet në këto raste: | 1. Early retirement on the initiative of the institution can be made in the following cases: | 1. Prevremeno Pensionisanje pod iniciativom institucije može se desiti u sledećim slučajevima: |
| 1.1. kur institucioni bën riorganizimin; | 1.1. when the institution is reorganized; | 1.1. kada institucija izvrši reorganizovanje; |
| 1.2. kur institucioni ose njësia organizative bashkohet me një njësi tjetër organizative brenda ose jashtë institucionit; | 1.2. when the institution or organizational unit merges with another organizational unit within or outside the institution; | 1.2. kada institucija ili organizacijona jedinica spaja se sa drugom organizacijonom jedinicom unutar ili van institucije; |
| 1.3. kur institucioni ose njësia organizative suprimohet dhe | 1.3. when the institution or organizational unit is closed, and | 1.3. kada institucija ili organizacijona jedinica se suprimira i |
| 1.4. si masë disiplinore për pensionim të parakohshëm. | 1.4. early retirement as disciplinary measure. | 1.4. kao disiplinska mera za Prevremeno Pensionisanje. |
| 2. Pensioni i parakohshëm i nëpunsëve civilë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund | 2. Early retirement of civil servants, under paragraph 1 of this article, can be done only | 2. Prevremeno Pensionisanje civilnih službenika, prema stavu 1istoga člana, može |

| | | |
|---|---|---|
| të bëhet vetëm nëse nëpunësi civil është jo më shumë se dy vjet para moshës për pensionim. | if the civil servant has only two years left till the retirement age. | biti samo ukoliko civilni službenik je u godinama ne više od dve godine prije pravog pensionisanja. |
| **Neni 7**<br>**Njoftimi për pensionim të parakohshëm** | **Article 7**<br>**Notice for early retirement** | **Član 7**<br>**Obaveštenje o prevremenom Penzijonisanju** |
| 1. Institucioni, në pajtim me nënparagrafët 1, 2 dhe 3 të paragrafit 1 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, duhet t'i njoftojë nëpunësit civilë gjashtë muaj para datës së pensionimit të parakohshëm. | 1. Institution, under subparagraph 1, 2 and 3 of paragraph 1 of article 6 of this Regulation, shall inform the civil servant six months prior the date of early retirement. | 1. Institucija, s hodno podstava 1, 2 i 3 stava 1 člana 6 ove Uredbe, treba da obaveštava civilnog službenika šest meseci prije dana prevremenog pensionisanja. |
| 2. Në rastin e pensionimit të parakohshëm, që është pasojë e masës disiplinore, nëpunësi civil njoftohet me rastin e shqiptimit të masës. | 2. In case of early retirement as a consequence of disciplinary measure, the civil servant shall be informed upon imposing the measure. | 2. Prilikom prevremenog pensionisanja, koja je posledica disciplinske mere, civilni službenik obaveštava se prilikom izričenja mera. |
| **Neni 8** | **Article 8** | **Član 8** |
| 1. Njësia e personelit, në pajtim me nënparagrafët 1, 2 dhe 3 të paragrafit 1 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, do t'i identifikojë nëpunësit civilë, të cilët kanë edhe dy vjet para moshës së pensionimit. | 1. The personnel unit, under subparagraphs 1, 2 and 3 of paragraph 1 of article 6 of this Regulation, shall identify civil servants who have two years left till the retirement age. | 1. Jedinica personela, shodno podstava 1, 2 i 3 stava 1 člana 6 ove Uredbe, treba identifikovati civilne službenike, koji imaju još dvije godine prije starosti za pensionisanje. |
| 2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, | 2. Under paragraph 1 of this article, the | 2. Shodno stava 1 ovoga člana, jedinica |

| | | |
|---|---|---|
| njësia e personelit i dërgon udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit të dhënat e nëpunësve civilë, që kanë arritur moshën e pensionimit të parakohshëm. | personnel unit shall send to the highest administrative manager of the institution the records of civil servants who have reached the early retirement age. | personela, dostavlja višem upravnom rukovodiocu institucije podaci o civilnom službeniku, koji su postigli starost za prevremeno pensionisanje. |
| 3. Udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit do të shqyrtojë të dhënat e dërguara nga njësia e personelit dhe do të vendosë për çdo rast, me vendim për pensionim të parakohshëm të nëpunësit civil. | 3. The highest administrative manager of the institution shall review the records sent by the personnel unit and decide on early retirement of civil servant for every case. | 3. Viši upravni rukovodilac institucije ima da razmatra dostavljene podatke od jedinice personela i treba da donese odluku za svaki slučaj, odlukom prevremenog penzionisanja civilnog službenika. |
| 4. Njësia e personelit do t'i informojë të gjithë nëpunësit civilë me vendimin e marr nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit për pensionimin e parakohshëm. | 4. The personnel unit shall inform all civil servants on the decision for early retirement taken by the highest administrative manager. | 4. Jedinica personela informiše svakog civilnog službenika sa donetom odlukom od strane višeg upravnog rukovodioca institucije za prevremeno penzionisanje. |
| **Neni 9**<br>**Kompensimi për pensionim të parakohshëm** | **Article 9**<br>**Compensation for early retirement** | **Član 9**<br>**Nadoknada prevremenog penzijonisanja** |
| 1. Nëpunësi civil, që pensionohet para kohe sipas dispozitave të Ligjit dhe të kësaj Rregulloreje, në bazë të kërkesës së tij, të institucionit apo si pasojë e masës disiplinore, institucioni i tij do t'i paguajë shumën mujore prej 70% të pagës te fundit bazë të nëpunësit civil për periudhën e | 1. The early retired civil servant, under provisions of the Law and this Regulation, based on his/her request, on the institution's request or as a consequence of disciplinary measure, shall be paid by his/her institution the amount of 60% of basic salary of civil servant for the remaining period until the | 1. Civilni službenik, koji se penzioniše prije vremena prema odredbama Zakona i ove Uredbe, na osnovu njegovog zahteva, institucije ili kao posledica disciplinske mere, njegova institucija ima da plaća iznos mesečne plate od 60% od platne osnovice civilnog službenika za period koji je ostao |

| | | |
|---|---|---|
| mbetur deri në moshën e pensionimit të vjetërsisë. | retirement age. | do dana starosti za penzijonisanje. |
| 2. Kur nëpunësi civil i pensionuar para kohe sipas kësaj Rregulloreje arrin moshën e pensionimit gëzon të drejtën e pagesës së pensionimit. | 2. When the early retired civil servant, under this Regulation, reaches the retirement age, he/she will enjoy the right for retirement payment. | 2. Do dana kada civilni službenik koji se penzijonisao prije vremena prema ove Uredbe postiže pravo penzijonisanje i pravo na isplatu penzije. |
| **Neni 10**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 10**<br>**Entry into force** | **Član 10**<br>**Nastupa na snagu** |
| Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit. | This regulation shall enter into force on the day signed. | Ova Uredba nastupa na snagu dana potpisivanja. |
| Hashim Thaçi, | Hashim Thaçi, | Hashim Thaçi, |
| ___________________________<br>Kryeministër i Republikës së Kosovës<br>Prishtinë, më ____/____2012 | ___________________________<br>Prime Minister of Republic of Kosovo<br>Prishtina, on ____/____2012 | ___________________________<br>Premijer Republike Kosova<br>Priština, dana ____/____2012 |